

VENDIM
Nr. 478, datë 30.7.2021

PËR LEJIMIN E PËRDORIMIT TË BRIGJEVE DHE TË ZONËS PËRKATËSE TË PLAZHIT PËRBALLË KOMPLEKSIT, NË FUNKSION TË REALIZIMIT TË PROJEKTIT INVESTUES STRATEGJIK “HOTEL CHAONIANS DELUXE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit, në funksion të realizimit të projektit investues strategjik “Hotel Chaonians DeLuxe”, Dhërmi, Himarë, i cili, me vendimin nr. 14/6, datë 4.2.2021, të Komitetit të Investimeve Strategjike, ka përfituar statusin “Investim/Investitor Strategjik Procedurë e Asistuar”.

2. Afati për përdorimin e brigjeve dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit, sipas këtij vendimi, të jetë 30 (tridhjetë) vjet, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Bashkia Himarë ka detyrimin që, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së investitorit strategjik “Ilir Trebicka”, me NUIS L81413013O, të lidhë kontratën përkatëse për lejimin e përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit, në përputhje me sipërfaqet e destinacionin e kërkuar nga subjekti, të lejuara me vendimin nr. 14/6, datë 4.2.2021, të Komitetit të Investimeve Strategjike, dhe të konfirmuara më tej nga Bashkia Himarë.

4. Investitori strategjik “Ilir Trebicka”, me NUIS L81413013O, duhet të paraqesë pranë Bashkisë Himarë kërkesën dhe dokumentacionin, si më poshtë vijon:

- a) ekstraktin e 3 (tre) muajve të fundit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;
- b) planvendosjen e sipërfaqes, për të cilën subjekti kërkon të lidhë kontratë me njësinë e vetëqeverisjes vendore;
- c) përshkrimin e aktivitetit që do të realizojë në sipërfaqen për të cilën kërkon të lidhë kontratë.

5. Përdorimi i brigjeve dhe i zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit të kryhet përgjatë periudhës së sezonit veror, të përcaktuar në aktet nënligjore në fuqi për turizmin, përkundrejt pagesës së tarifës, në përputhje me tarifën e plazheve, të përcaktuar në vendimin e Këshillit Bashkiak Himarë. Kjo tarifë të aplikohet vetëm mbi sipërfaqen objekt kontrate, sipas pikave 3 dhe 4, të këtij vendimi, të lidhur me Bashkinë Himarë, përgjatë periudhës së përmendur në këtë pikë.

6. Të ardhurat e mbledhura nga tarifa për dhënien e së drejtës së përdorimit të brigjeve dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit administrohen dhe bëjnë pjesë në buxhetin e Bashkisë Himarë.

7. E drejta e përdorimit të brigjeve nga ana e investitorit strategjik “Ilir Trebicka”, me NUIS/NIPT: L81413013O, sipërfaqja e lejuar për përdorim afatgjatë dhe kushtet e përdorimit bazohen në vendimin nr. 14/6, datë 4.2.2021, të Komitetit të Investimeve Strategjike, dhe në përputhje me përcaktimet e kontratës përkatëse, që investitori strategjik duhet të lidhë me Bashkinë Himarë.

8. Ngarkohet Bashkia Himarë për lidhjen e kontratës përkatëse me investitorin strategjik, në zbatim të këtij vendimi dhe të vendimit nr. 14/6, datë 4.2.2021, të Komitetit të Investimeve Strategjike. Në këtë kontratë të parashikohen shprehimisht të drejtat e detyrimit e autoritetit kontraktues dhe të drejtat e detyrimit e investitorit, në funksion të projektit të investimit

strategjik, si dhe penalitetet përkatëse. Kontrata për dhënien me qira të përdorimit të brigjeve të detit dhe të zonës përkatëse të plazhit përballë kompleksit, me koordinata sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, nën juridiksion të Bashkisë Himarë, të ketë afat një periudhë 30-vjeçare, me kusht që investitori të mos ndryshojë destinacionin e pronës (përfshirë, por pa u kufizuar, ndërtimin, dhënien me qira palëve të treta).

9. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Bashkia Himarë dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

SHTOJCA NR. 1
KOORDINATAT PËR PROJEKTIN “HOTEL CHAONLANS DELUXE”

Nr.	E	N
1	380842.5157	4446425.396
2	380817.7836	4446367.078
3	380818.847	4446366.067
4	380821.629	4446366.275
5	380824.229	4446366.525
6	380827.659	4446368.482
7	380828.121	4446372.213
8	380830.322	4446373.34
9	380833.844	4446378.065
10	380835.6944	4446383.285
11	380835.8449	4446383.304
12	380837.701	4446383.105
13	380841.724	4446380.758
14	380851.287	4446376.739
15	380865.33	4446371.5
16	380878.586	4446364.922
17	380895.941	4446357.601
18	380913.371	4446348.772
19	380931.607	4446340.321
20	380952.866	4446330.438
21	380965.2118	4446325.301
22	380987.0051	4446386.084
23	380967.1012	4446393.939
24	380965.8469	4446386.305
25	380926.8005	4446394.953
26	380891.2688	4446409.597
27	380864.8616	4446420.48
28	380859.8046	4446413.052
29	380844.2937	4446398.544
30	380833.6087	4446399.958